

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 105 REP
Nr. 10 kol.



KONTRATE E SHITJES SE AKSIONEVE

Sot me date 10, 01. 2005, para meje noter Agim.Xh.Robo me zyre noterie ne rrugen "Ismail Qemali", P27/1, u paraqiten personalisht palet me cilesite perkatese:

SHITES: Lefter SOTA, biri Panajotit, dl, 1956, lindur ne Vlore, banues ne Tirane, identifikuar me dokument nr. Z 0114043, me zotesi juridike e te plote per te vepruar, zoterues i 50% te aksioneve ne shoqerine "PANORAMA GROUP" sh.a.

BLERES: Irfan HYSENBELLIU, biri Hasanit, dl. 1959, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane, rruga "Vaso Pasha" P.8, identifikuar me dokument nr. 1762730, me zotesi juridike e te plote per te vepruar, zoterues i 50% te aksioneve ne shoqerine "PANORAMA GROUP" sh.a.

Te dy palet me vullnetin e tyre te lire kerkuan prej meje Hartimin e Kontrates noteriale me:

OBJEKT: Transferim nepermjet shitjes se aksioneve.

BAZA LIGJORE: Ligji 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"

PERMBAJTJA E KONTRATES:

Shoqeria anonime "PANORAMA GROUP" sh.a. eshte regjistruar si person juridik me Vendim nr.28161, date 05.09.2002, me kapital themeltar 10.000.000 leke. Objekti, Aksioneret, pjeset e tyre takuese mbi aksionet e kapitalit themeltar, selia, kohezgjatja, etj percaktohen ne Statutin dhe Aktin e Themelimit.

Me Vendim nr.28161/1, date 12.03.200, jane depozituar aktet e shoqerise per ndryshime te Aksionereve. Aksionere te shoqerise jane z.Lefter SOTA zoterues i 50% te Aksioneve me vlere nominale 5.000.000 leke dhe z.Irfan HYSENBELLIU zoterues i 50% te Aksioneve me vlere nominale 5.000.000 leke.

Asambleja e Aksionereve me Vendimin e saj nr.4 date 10. 01. 2005, ka vendosur Miratimin e Transferimit te aksioneve nepermjet shitjes. Ne zbatim te tij, SHITESI Aksioner z.Lefter SOTA i shet teresisht BLERESIT Aksioner z.Irfan HYSENBELLIU aksionet e tij prej 50% ne Kapitalin themeltar te shoqerise me vleren prej 5 000 000 (pese milion)leke.

BLERESI z.Irfan HYSENBELLIU pranon blerjen e 50% te Aksioneve te shitura prej z.Lefter SOTA me vleren prej 5 000 000 (pese milion)leke dhe sipas deklarimit te paleve, eshte shlyer plotesisht vlera e tyre. Ne keto kushte transferimi eshte i kryer edhe nepermjet regjistrimit te ketij operacioni ne regjistrin e aksioneve te shoqerise dhe shlyerjes se plote te vleres perkatese.

Aksioneri Z.Irfan HYSENBELLIU fiton pronesine e 50% te aksioneve te shitura nga z.Lefter SOTA, i cili humbet zoterimin mbi to si dhe cilesine e Aksionerit te shoqerise « PANORAMA GROUP » sh.a. duke u larguar prej saj.